


TË BASHKUAR



SHKOJMË PËRPARA

PUSHTETI LEGJISLATIV

JAHIR (13), MUHAMET (13), DRENUSHA (13), REJHANE (13), ORHIDEA (13), HAJRIJE (13)



Katër shtyllat e Kuvendit të Kosovës

DEMOKRACIA

Demokracia është formë e qeverisjes, e cila udhëhiqet nga populli. Fjala demokraci ka prejardhjen nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë pushtet. Domethënë demokracia është



pushtet i popullit. Demokracia ndahet në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe demokracinë përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë shtrihet në disa shtete. Njëri prej tyre është edhe shteti i Zvicrës. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli, nëpërmjet referendumit, mund të ndërron ligje në shtetin ku jeton. Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur populli nëpërmjet votës zgjedh deputetët, të cilët janë përfaqësues të popullit në Kuvend. Republika e Kosovës ka formën e demokracisë përfaqësuese.

KUVENDI

Kuvendi është vendi ku të zgjedhurit e popullit (deputetët) zhvillojnë punën e tyre. Ky institucion është vendi ku shqyrtohen projektligjet, ku miratohen ligjet, etj. Detyrat e Kuvendit janë: përfaqëson interesat e popullit, mbikëqyr Qeverinë dhe miraton ligjet dhe buxhetin e shtetit. Kuvendi përbëhet prej njëqind e njëzet (120) deputetëve. Njëqind (100) prej ulëseve i përkasin komunitetit shqiptar, kurse njëzet (20) të tjera i përkasin komuniteteve jo shumicë. Në komunitetin jo shumicë hyjnë: serbët, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët, kroatët, goranët dhe turqit. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës mandati i një deputeti zgjatë katër vjet me mundësi vazhdimi, vetëm me rikandidim në zgjedhje parlamentare.



Këta janë autorët e këtij artikulli

UNË KAM TË DREJTË TË VOTOJ

VALDRINA (13), SUREJA (13) ARBËRESHA (13), AGNESA (13), ALTIN (14), RONITA (13)



Vota



Ne duhet të votojmë

Sot u mbajtën zgjedhjet në shollën tonë për Presidentin e Kosovës dhe kandiduan: Altini, Arbëresha, Agnesa, Sureja, Ronita dhe Valdrina. Sipas shumicës së votave, Presidente u zgjodh: Sureja nga partia "Ylli". Pas zgjedhjeve, Presidentja jonë mbajti një fjalim të shkurtër. Siç dihet në Kosovë kemi vetëm një zonë zgjedhore. Në Kosovë kemi 2 lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet komunale dhe ato qendrore. Zgjedhjet komunale mbahen për të zgjedhur asambleistët dhe kryetarin e komunës. Kurse, zgjedhjet qendrore mbahen për të zgjedhur deputetët e Kuvendit të Kosovës. Të drejtën e votës kanë personat mbi moshën 18 vjeçare. Ndërsa një person nuk mund të votoj për më shumë se një parti politike.



Ne punojmë për një të ardhme më të mirë



Si duhet të jetë një lider

NDARJA E PUSHTETIT NË DEMOKRACI

ARGJENDI (14), QËRSHIZA (14), RIAD (14), DIONI (14), ERDON (14), ARRON (14)



Ne do të flasim për Kuvendin, Qeverinë dhe gjykatat në Kosovë

Në një vend demokratik, siç është Kosova, populli e ka pushtetin. E ai pushtet ndahet në tri pjesë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor. Pushteti Legjislativ (Kuvendi), përbëhet prej 120 deputetëve. 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë si: boshnjakë, serbë, romë, ashkalinjë etj. Kurse, 100 vende të tjera iu takojnë pjesëtarëve të komunitetit shumicë.

Në Kuvend bëjnë pjesë: Kryesia e Kuvendit dhe deputetët, të cilët përfaqësojnë popullin. Pushteti Ekzekutiv, Qeveria përbëhet nga partia apo partitë politike, të cilët janë pozitivë, që do të thotë se ata i kanë fituar shumicën e votave në zgjedhjet e fundit parlamentare. Në Qeveri punojnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat, zëvendësministrat, ministrat, këshillëtarët, etj. Kurse, Pushteti Gjyqësor (gjykatat) përbëhet prej: gjykatësve, prokurorëve, avokatëve, të cilët vënë drejtësi në vend. Qeveria propozon ligje, të cilat pastaj shkojnë në Kuvend dhe miratohen nga deputetët me anë të votave të tyre.

Ligjet të cilat propozohen nga Qeveria duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën e vendit. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti. Një ndarje si kjo e pushtetit në demokraci, ndodh edhe

në jetën e përditshme. Marrim shembull, ndarja e detyrave në klasë, siç është detyrat e ndryshme të kryetarit, sekretarit, arkatarit, etj.


Këso lloj ndarje sh kemi edhe në shtëpi. Ne e ndajmë orarin gjatë të cilit secili anëtar do t'i kryejë obligimet e shtëpisë. Obligim i njërit anëtar mund të jetë rregullimi i dhomës së fjetjes, i një anëtari tjetër pastrimi i enëve, etj. Kjo do të thotë se nëse të gjithë e kryejnë pjesën e tyre të përgjegjësisë siç duhet, si në institucione shtetërore, në shkollë, ashtu edhe në shtëpi, shteti do të forcohet dhe do të zhvillohet në vazhdimësi.




Qërshiza gjatë punës së saj



Pa punë nuk do të ketë progres



Duke shkruar këtë gazetë që ju po e lexoni



Gjykata vendos drejtësi në vend



Votimi i ligjeve në Kuvend



Gazetarët duke bashkëpunuar



Demokraci për të gjithë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@toka-ks.org
Website: www.toka-ks.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Afrim Gashi“
Klasa: VIII-2
Vendi: Hajvali, Prishtinë